



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 14.

Prishtinë, më 24.03.2015 në ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Valdete Bajrami, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Luljeta Veselaj- Gutaj, Ilir Deda, dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Xhavit Haliti, Time Kadriaj, Rustem Mustafa dhe Sllobodan Petroviç.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqia – kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e dt. 02.03.2015 dhe 17.03.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja e vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja Teuta Sahatqija pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 02.03.2015 dhe 17.03.2015

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja e vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lidhur me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor , Projektligji ka për qëllim të rregulloj monitorimin elektronik të procesit të drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutimin efektiv të vendimeve të Gjykatës dhe të Panelit për lirim me kusht, ka gjithsejtë 21 nene dhe 17 amendamente të komisionit funksional

Pas shqyrtimit dhe analizimit të Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilët u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, dhe amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, u konstatua që nuk janë në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar, përkatësisht të *Acquis* të Bashkimit Evropian dhe mund të procedohen për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend

Lidhur me këtë hapi diskutimin Vjosa Osmani theksoj se shumica e amendamenteve të komisionit funksional janë teknike Po ashtu edhe Luljeta Veselaj- Gutaj e kishte të njëjtin mendim, vetëm vendi i fjalëve është ndryshuar sepse kuptimi ka mbet i njëjtë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligjit nr. 05/L-03 për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja e vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar, përkatësisht të *Acquis* të Bashkimit Evropian.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja lidhur me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ka për qëllim parandalimin e konfliktit ndërmjet interesit publik dhe interesit privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksionit publik.

Projektligji përmban gjithsej 13 nene dhe 7 amendamente të komisionit funksional.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të projektligjit u konstatua se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk paraqet shkelje të parimeve të “*Acquis*” të BE-së.

Lidhur me këtë projektligj hapi diskutimin

Vjosa Osmani kërkoj mendimin edhe prej stafit të komisionit lidhur me amendamentin 5 të cilin e lexoj.

Nëse ndaj zyrtarit të lartë gjat dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë , haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të mar vendim konkret, ai njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ka bazë të lajmërohen organet e ndjekjes.

Ajo tha se a nënkupton kjo për shembull nëse kryetari i grupit parlamentar ushtron ndikim te deputet të vet për me votua në një mënyrë apo tjetrën.

Ilir Deda mendon se në këtë rast ka një lloj kontradikte se zyrtarin e lart po e përgjithësojnë,ne si deputet jemi zyrtar të lart atëherë kishte qen më mirë me u specifiku më tepër, sepse ndryshe është votimi në Kuvend e ndryshe në institucionet publike.

Kryetarja tha se nëse e lexojmë ligjin bazik mundemi me pas më tepër informata.

Ne si komision kemi për detyrë me e analizua projektligjin është në përputhje me legjislacionin e BE-së së , kurse për amendamente tjera kemi të drejt të diskutojmë.

Vjosa Osmani edhe në aspektin e BE-së është mirë me e shikua praktikat më të mira se a kanë nene të tilla ata.

Arben Gashi konsideron se në këtë rast i jep kapacitete të abuzimit agjencisë.

Ilir Deda mendon se parimisht nuk ka gabim asgjë me këtë lloj specifikimi sepse është një mbrojtje ligjore prej presionit,por e kishte paqartësi se pse tha se nuk e din se a është në harmoni me ligj bazik, nëse ne kemi konflikt mes të ligjeve të cilat duhet me e rregullua një fushë ,atëherë kjo nuk është në përputhje me atë çka kërkohet prej neve me pas harmonizim të ligjeve qysh kërkohet edhe me Acquis të BE-së,andaq konsideron se duhet nga komisioni për legjislacion me kërkua sqarim se e kemi të pa çart.

Arben Gashi mendon se komisioni për legjislacion nuk e bënë at gabim por problemi është te përmbajtja çka konsiderohet zyrtar i lart,çka nënkupton me këtë ndërhyrje, ne e kemi një problem shumë madhor, a po i japim instrument ndonjë institucioni me e keqpërdor apo po e ruajmë prej keqpërdorimit.

Kryetarja e lexoj në ligjin bazik nenin 6 dhe e konstatoj se ky amendamenti 5 eshtë i njëjtë dhe nuk e dimë pse është bërë .

Arben Gashi duhet kërkuar sqarime shtesë prej komisionit për legjislacion se çka nënkupton ky nen dhe cilat janë implikimet e tij të mundshme dhe a e bën diferencën mes personit të zgjedhur politik dhe personit zyrtar, krejt në rregull që personi politik mos me ushtrua ndikim te shërbyesit civil me marrë vendime.,po flasim për dy nivele për të zgjedhur dhe të emëruar.

Kryetarja ne gjithë kohen po themi se termi zyrtar i lart publik është zëvendësuar me personin zyrtar ndërsa te projektligji e kanë lan prapë, dmth fuqia bazike për të cilën është bërë projektligji në fakt në amendamentin 5 dhe 6 e rikthen prapë të njëjtin.

Vjosa Osmani te amendamenti 6, neni 16.3 ku thuhet se zyrtari i lart publik nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë ,tha se e kishte të pa çart se çka nënkupton me këtë në mënyrë aktive , pra çka nënkuptojmë me ushtrim aktiv të të drejtës së pronësisë ose e ki të drejtën e pronësisë mbi një pronë ose nuk e ki dhe nuk sqarohet se a është fjala për ndonjë firmë, kompani apo për pronë private.

Kryetarja tha se sa i përket ndërmarrjeve e di se nuk mundesh me qen menaxher ,por duhesh me e marrë një menaxhues tjetër dhe nuk ke të drejt të nënshkruarit të kontratave dhe transaksioneve bankare. Kjo me siguri është e rregulluara edhe me ndonjë ligj tjetër , me Ligjin e antikorupcionit apo diçka tjetër po gjithsesi ajo nuk e mbulon krejt çështjen e pronësisë.

Vjosa Osmani po ashtu edhe te amendamenti 6.4 në të cilën thuhet se zyrtari i lart nuk mund të ushtroj më shumë se një funksion në sektorin publik,tha se nëse konsiderohet universiteti publik funksion në sektorin publik atëherë i bie që të gjithë zyrtarët qofshin në Kuvendin e Kosovës qofshin në Qeveri dhe kudo në institucione që punojnë ,nënkupton që asnjëri prej tyre nuk guxon me ligjërua në Universitetin publik. Deri më tani është lejua dhe nëse ky ndryshim po bëhet që mos me lejua është mirë me dit.

Kryetarja pas diskutimeve një zëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e Funksionit publik, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, kurse amendamenti nr. 5 dhe amendamenti nr.6 kërkohet të qartësohen nga Komisioni funksional.

Amendamenti nr. 5 i Komisionit funksional, komisioni ka vlerësuar se duhet të qartësohen se çka nënkupton ndryshimi i nenit 6 të projektligjit ku ndryshohet neni 12 paragrafi 2 i ligjit bazik i cili thotë” Nëse ndaj zyrtarit të lartë gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marrë vendim konkret, ai njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ka bazë të lajmërohen organet e ndjekjes” .

Komisioni vlerësoi se këtu duhet të sqarohet ky amendament sa i përket çështjes kur përmendet votimi apo vendimi konkret. Pra të saktësohet se për çfarë votimi bëhet fjalë, a përfshihet edhe votimi për çështje të politikave të ndryshme si dhe të mos jetë si amendament i përgjithësuar.

Po ashtu, amendamenti nr. 6 i Komisionit funksional i cili ndryshon nenin 9 të projektligjit, “neni 16 i ligjit bazik“, paragrafi 3 përcakton se “Zyrtari i lartë Publik nuk mund të ushtroj në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj”, Komisioni vlerëson se duhet të jepet një shpjegim se çka nënkupton mos ushtrimi i të drejtës aktive të pronësisë nga zyrtari i lartë.

Të ndryshme

Kryetarja hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Ilir Deda lidhur me këtë pikë ngrii 3 çështje:

1. Kërkoj të përshpejtohet zbatimi i planit të punës duke kërkuar që të ftohet shefi i EULEX-it në raportim sidomos në vazhden e diskutimeve në Bruksel për rredfinimin komplet të këtij misioni.
2. Të thirret në komision ministri i Drejtësisë dhe ministrja e tregëtisë dhe industrisë për të diskutuar për temat të cilat i kemi caktuar në plan të punës
3. Konsideron që kishte qenë mirë që ne emër të Komisionit me ja dërgua një letër proteste Zyres së BE-së, sepse nuk kanë parapa asnjë takim me Komisionerin Han dhe komisioneren

Mogerini dhe se po injorohet komisioni me rastin e vizitave të zyrtarëve të BE-së, me arsyetimin e pa qëndrueshëm për mungesë kohe.

Kryetarja sa i përket këtyre vizitave të Komisionerëve tha se me letër nuk i është drejtua por me telefon pasditen e djeshme gjithë kohën kishte protestua për shkak të injorimit dhe than se janë duke shiqu me na organizua një takim me Mogerinin, pa marr parasysh a do të organizohet apo jo ka vend me ja dërgua një letër sepse edhe herën e kaluar jemi injoruar kur ishte komisionari Han.

Në vazhdim tha se do të ishte mirë me GIZ-in ta organizojmë një tryezë dhe tani të diskutojmë për temat të cilat duhet ti diskutojmë, në fillim ishte migrimi por tani do të ishte mirë të diskutojmë për proceset integruese pastaj IPA fondet dhe nëse keni propozime ti paraqitni tani ose i dërgoni me e-mail.

Ilir Deda propozoj që stafi i komisionit me hartu një listë të prioriteteve çka nevojitet që të fuqizohet ky komision dhe pas diskutimeve në komision ti thërrasim donatorët dhe të kërkojmë që të na përkrahim për atë çka na duhet në Komision, pra pas identifikimit të nevojave të komisionit të bisedojmë pastaj me GIZ -in dhe do të ishte mirë që me bo tryezë me përfaqësuesit diplomatik që janë në Kosovë në fushë të integrimit kurse donatorët të vijnë në përkrahje të prioriteteve të Komisionit të cilat i identifikon stafi..

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj. Teuta Sahatqia
